

NJOFTIM PËR MEDIA MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES PLENARE DATË 17.05.2024

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, u mbledh sot, në datë 17.05.2024, në seancë plenare, në prani të 10 (dhjetë) anëtarëve dhe në prani të përfaqësuesve nga Ministria e Drejtësisë, Misioni OPDAT dhe EU4JUST.

Gjatë kësaj seance u miratuan aktet si më poshtë:

1. Caktimi i Përkohshëm i prokurores Anita Jella, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
2. Caktimi i Përkohshëm i prokurorit Genti Xholi në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
3. Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Genti Xholi, në kuadër të kandidimit për riemërim për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
4. Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024, zonjës Enkelejda Meçka dhe zonjës Ema Lazaj;
5. Për miratimin e programit që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional me kërkesë për vlerësim të përshpejtuar të paraqitura në kuadër të procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në Prokuroritë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, shpallur me Vendimin Nr.13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe caktimin e relatorit dhe këshilltarit përgjegjës për këto procedura vlerësimi;
6. Hedhja e shortit Për caktimin e relatorit dhe këshilltarit përgjegjës për vlerësimet etike dhe profesionale me procedurë të përshpejtuar për prokurorët të cilët kanë paraqitur kërkesë në kuadër të procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në Prokuroritë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, shpallur me Vendimin Nr. 13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ku rezultoi:

Prokurori	Relator	Këshilltar ligjor
1. Aida Cakaj	Tartar Bazaj	Andi Pogaçe
2. Alma Bramo	Olger Eminaj	Gentian Habazaj
3. Enkelelda Hoxha	Moisi Duda	Olgert Rumnici
4. Erida Visoçi	Tartar Bazaj	Armida Hamiti (Moçka)
5. Erjon Shqarri	Tartar Bazaj	Ylli Pjetërnikaj
6. Ermira Manelli	Olger Eminaj	Gentian Habazaj
7. Françesk Ganaj	Moisi Duda	Olgert Rumnici
8. Gëzim Spahiu	Moisi Duda	Olgert Rumnici
9. Gjergji Ceka	Moisi Duda	Andi Pogaçe
10. Ledion Tema	Olger Eminaj	Armida Hamiti (Moçka)
11. Mediana Meta	Tartar Bazaj	Armida Hamiti (Moçka)
12. Riselda Fishta	Tartar Bazaj	Ylli Pjetërnikaj
13. Xhoana Mehmetaj	Moisi Duda	Ylli Pjetërnikaj

7. Për miratimin e rregullores për përmbajtjen e programeve të formimit vazhdues, shërbimet lehtësuese të lejuara si dhe pajisjen me leje për ndjekjen e trajnimeve.

Gjithashtu, në këtë Seancë Plenare u diskutua kërkesa e prokurores Pranvera Gruda për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, si dhe vendimi i zyrës përmbartimore lidhur me këtë vendim gjykate, ku u konkludua që komisioni përgjegjës do të sjellë qëndrimin në mbledhjen plenare të radhës.